

LIGJ
Nr.9389, datë 4.5.2005

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOORDINUES
NË LUFTËN KUNDËR GJAKMARRJES

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të organizojë dhe të koordinojë më mirë masat dhe luftën e organeve shtetërore, institucioneve të tjera shoqërore, shkencore, fetare etj., si dhe të përcaktojë një strategji afatgjatë për parandalimin dhe eliminimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri.

Neni 2
Krijimi i Këshillit Koordinues

Krijohet Këshilli Koordinues nën drejtimin e Presidentit të Republikës, me pjesëmarrjen e Zëvendëskryeministrit, Ministrit të Rendit Publik, Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Prokurorit të Përgjithshëm, Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Avokatit të Popullit.

Në mbledhjen e Këshillit Koordinues ftohen të marrin pjesë përfaqësues të organizatave jofitimprurëse në fushën e të drejtave të njeriut dhe të besimit.

Neni 3
Veprimtaria dhe funksionet e Këshillit Koordinues

Këshilli Koordinues:

a) harton strategjinë kombëtare për luftën kundër gjakmarrjes në planin ekonomik, social, legjislativ etj. dhe përcakton detyrat dhe masat konkrete për organet ekzekutive e ato të pushtetit vendor;

b) nxit koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse për organizimin e luftës kundër fenomenit të gjakmarrjes;

c) thërret në raport një herë në tre muaj organet e përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes dhe u cakton atyre detyra konkrete, sipas fushës së veprimtarisë që kryejnë;

ç) u sugjeron organeve përkatëse, të ngarkuara me detyra sipas këtij ligji, nxjerrjen e përgjegjësisë dhe marrjen e masave për strukturat dhe personat përgjegjës të ngarkuar për t'i kryer ato.

Neni 4
Bashkëpunimi me organet shtetërore

Këshilli Koordinues, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Rendit Publik dhe Prokurorit të Përgjithshëm, evidenton, nëpërmjet studimeve që kryejnë këto organe, përhapjen dhe shtrirjen e krimit të gjakmarrjes e të fenomeneve të tjera që lidhen me të në shkallë Republike dhe orienton përgatitjen e nismave ligjore në fushat përkatëse.

Neni 5
Koordinimi me qeverisjen vendore

Këshilli Koordinues përcakton platformën dhe mënyrën e organizimit dhe të koordinimit të veprimtarisë me organet e qeverisjes vendore.

Neni 6
Sekretariati Teknik

Pranë Këshillit Koordinues ngrihet Sekretariati Teknik, i cili ndjek detyrat dhe ndihmon Këshillin Koordinues në kryerjen e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj. Organizimi dhe funksionimi i tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7
Aktet nënligjore

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, 5 dhe 6 këtij ligji.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4595, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**